



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 3.1, 3.4, 15.1 pikat (a) dhe (c) dhe 21.2, 37, 38 dhe 39 të ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, Nr 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të ofrimit të Licencimit të personelit në Republikën e Kosovës në përputhje me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara të përcaktuara në Aneksin 1 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar,

Pasi përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 4 /2014 MBI LICENCIMIN E PERSONELIT

Neni 1

Fusha e zbatimit

1.1 Kjo Rregullore përcakton kërkesat për ofrimin e Licencimit të personelit në përputhje me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara (SPR) përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në Aneksin 1 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

1.2 Ofrimi i Licencimit të personelit në Republikën e Kosovës do të rregullohet sipas SPR të Aneksit 1 dhe Shtojcave 1-4, shtesave A, B dhe C, siç janë publikuar në Botimin e 11 korrikut të vitit 2011 nga ONAC.

Neni 2

Zbatimi i SPR-ve

2.1 Aneksi 1 mbi Licencimin e personelit siç është përcaktuar sipas nenit 1 paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje do të jetë i zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2.2 SPR-të e zbatueshme të specifikuara në Aneksin 1 si dhe Shtesat dhe shtojcat e veta do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përveç nëse dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregulloreje përcaktojnë ndryshe.

Neni 3

Termet dhe Përkufizimet

3.1 Për qëllim të kësaj Rregulloreje termet “Shtet Kontraktues”, “Shtet”, “Autoritet përkatës” drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përdorura në njëjës apo në shumës në Aneksin 1 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç përcaktohet më sipër në nenin 1, paragrafi 2, do të lexohen si “Republika e Kosovës”.

3.2 Dallimet e listuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje në kuptim të kësaj Rregulloreje nënkuptojnë qoftë shmangien nga standardi ose ngritjen e një praktike të rekomanduar në nivel të standardit.

Neni 4

Dallimet nga SPR-të

4.1 Dallimet e zbatueshme nga SPR-të e Aneksit 1 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar siç është specifikuar në nenin 1, paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje janë listuar sipas renditjes së mëposhtme:

- a) Kapitulli 1 Definicionet dhe Rregullat e përgjithshme në lidhje me Licencat, Neni 1.2 Rregullat e përgjithshme në lidhje me licencat, Rekomandimi 1.2.9.3 zbatohen si standard pa ndryshime në tekst.
- b) Neni 1.2 Rregullat e Përgjithshme në lidhje me Licencat, Rekomandimi 1.2.9.7 zbatohet si standard pa ndryshime në tekst.
- c) Kapitulli 2 Licencat dhe gradat për Pilotët, Neni 2.1 Rregullat e përgjithshme në lidhje me licencat dhe gradat për pilotë, Rekomandimi 2.1.3.1.1 zbatohet si standard pa ndryshime në tekst.
- d) Neni 2.1 Rregullat e përgjithshme në lidhje me Licencat dhe gradat për pilotë, Rekomandimi 2.1.10.2 zbatohet si standard pa ndryshime në tekst.
- e) Seksioni 2.3.5 Kërkesat specifike për çështjen e gradave të kategorisë së avionëve me ngritje me motor, Rekomandimet 2.3.5.1.1, 2.3.5.1.3 dhe 2.3.5.2 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- f) Neni 2.4.5 Kërkesat specifike për çështjen e gradave të kategorisë së avionëve me ngritje me motor, Rekomandimet 2.4.5.1.1, 2.4.5.2 dhe 2.4.5.1.2 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- g) Neni 2.6 Licencë piloti e transportit të linjave ajrore, Rekomandimet 2.6.5.1.1, 2.6.5.1.2 dhe 2.6.5.2 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- h) Neni 2.7 Gradat instrumentale, Rekomandimi 2.7.1.3.2 zbatohet si standard pa ndryshime në tekst.
- i) Neni 2.9 Licenca e pilotit për avion pa motor, Rekomandimet 2.9.1.2.2 dhe 2.9.2.2 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.

- j) Neni 2.10 Licenca e pilotit për balon, Rekomandimet 2.10.1.2.2 dhe 2.10.1.3.4 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- k) Kapitulli 3 Licencat për anëtarët e ekuipazhit përveç licencave për Pilotët, Neni 3.3 Licenca për inxhinier fluturimi, Rekomandimi 3.3.1.2.2 zbatohet si standard pa ndryshime në tekst.
- l) Kapitulli 6 Dispozitat mjekësore për Licencim, Neni 6.2 Kërkesat për vlerësime mjekësore, Rekomandimet 6.2.3.2, 6.2.4.4.1 dhe 6.2.5.5 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- m) Neni 6.3 Vlerësimi Mjekësor i Klasit 1, Rekomandimet 6.3.1.2.1, 6.3.2.2.1, 6.3.2.6.2 dhe 6.3.2.9.1 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- n) Neni 6.4 Vlerësimi Mjekësor i Klasit 2, Rekomandimet 6.4.2.2.1 dhe 6.4.2.9.1 zbatohen si standarde pa ndryshime në tekst.
- o) Neni 6.5 Vlerësimi Mjekësor i Klasit 3, Rekomandimet 6.5.2.2.1 zbatohet si standarde pa ndryshime në tekst.

4.2 Dallimet e listuara në paragrafin 1 të këtij neni do të publikohen në Publikimin e Informatave Aeronautike (PIA), njëzet e tetë (28) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 5 Disponueshmëria

Teksti i SPR-ve të ndryshuara të Aneksit 1, siç është specifikuar në nenin 1, paragrafi 2, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje si Shtojca 1.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 19 shkurt 2014.

Prishtine, 4 shkurt 2014.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm